



PAVARËSIA SCIENTIFIC JOURNAL

ISSN 2304-2664(Online)

Volume 6, No 1, November 2021

Scientific Board

Prof. Dr. Hivzi **MUHARREMI** – Editor in Chief

Prof. Dr. Habib **HAMAM**

Prof. As. Dr. Clirim **DURO**

Dr. Siri **HOXHA**

Dr. Ervin **MUÇO**

Dr. Esmeralda **HOXHA**

Dr. Lindita **LIÇAJ**

Dr. Gerta **MEHMETI**

Dr. Syti **HYSKO**

Editor:

Dr. Siri **Hoxha**

Msc. Anduel **MEHMETI**.

Msc. Enerik **SHABANI**

Pavaresia Scientific Journal is not responsible for the opinions expressed by the authors. These opinions are of the authors of articles and do not express the positions neither of the University College "Pavarësia Vlorë" nor the Pavaresia Scientific Journal.

Publisher

University College Pavaresia Vlorë

Bulevardi Vlorë Skelë

PO.BOX 4358 AL-9401, Vlorë

Albania

Email: siri.hoxha@unipavaresia.edu.al

COPYRIGHT © University College "Pavarësia Vlorë"

All right reserved

TABLE OF CONTENTS

ANALIZË TEORIKE PËR PROCESIN E FORMIMIT TË PARTIVE TË REJA POLITIKE.

Elinda Guri4

NDIKIMI I INFERIORITETIT, MJEDISIT AGRESIV DHE PAPJEKURIA MENDORE NË KRIMINALITETIN E TË MITURVE.

MSc Lira Spiro, EM. Anila Fega.....12

INTERNATIONAL LAW COMMISSION ARTICLES ON STATE RESPONSIBILITY AND COVID-19 PANDEMIC

Sara MAHILAJ.....19

Ç'RREGULLIMET MENDORE DHE KRIMINALITETI

MSc. Kristina XHAFAJ (DODI).....25

THE IMPORTANCE OF AGRICULTURE AS A KEY FACTOR IN ALBANIA ECONOMIC DEVELOPMENT

Brisejda ÇAKËRRI.....32

ANALIZË TEORIKE PËR PROCESIN E FORMIMIT TË PARTIVE TË REJA POLITIKE.

Elinda GURI
Universiteti i Tiranës
Shqipëri
gurielinda@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë artikull do të bëhet një analizë e partive të reja politike nga pikëpamja teorike dhe e qasjeve të ndryshme për origjinën e tyre të krijimit. Si aktorë të rëndësishëm për artikulin e interesave të ndryshme por edhe në rastet e mospjekësive për ndryshimin e agjendave të partive tradicionale studimi i tyre paraqet interes. Do të bëhet një panoramë e përkufizimeve për partitë e reja politike, me theks të veçantë tek partitë me drejtues dhe anëtarë të rinj në sistemin partiak. Gjithashtu, do të përmenden grupet e partive të reja politike duke filluar nga vitet 1980 kur kemi shfaqjen e tyre si fenomen politik. Do të paraqiten tre qasjet dominante për origjinën e formimit të partive të reja politike konkretisht të qasjes sistimore e cila nënvizon ndryshimet ligjore, tek qasja sociologjike që shpegon origjinën e tyre duke u nisur nga ndarjet shoqërore dhe çështjet e reja të krijuara në shoqëri si dhe qasja për konkurrencën politike me partitë ekzistuese. Do të analizohet se përveç këtyre qasjeve të mëdha të cilat shpjegojnë origjinën e partive të reja, edhe projekti i të resë është një arsye e formimit të tyre e mbështetur mbi analizën e zhvilluar nga autori Allan Sick.

Key words: *Parti e re, Ndarje shoqërore, Konkurrencë Politike, Projekti i të resë.*

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për shkrimin e këtij artikulli është metodologjia cilësore e mbështetur në burime dytësore. Duke qenë se objekt studimi për këtë

artikull është analiza teorike e procesit të formësimit të partive të reja politike janë përdorur libra si dhe artikuj të autorëve që kanë shkruar për këto subjekte politike. Pas analizës së burimeve të ndryshme është bërë një paraqitje e qasjeve dhe paradigmave kryesore për procesin e formimit të tyre. Literatura e përdorur i përket periudhës kohore nga vitet 1980 deri në vitet 2008 dhe kjo pasi studimi i partive të reja politike si fenomen ka filluar pas viteve '80-të.

PARTITË E REJA POLITIKE

Partitë e reja politike nëse do t'i referoheshim autorit Hug, janë organizata politike të cilat janë të rëndësishme për t'u studiuar për të paktën tre arsye. Së pari, disa parti të reja, madje edhe kur fillojnë të vogla, janë aty për të zëvendësuar partitë ekzistuese pra tradicionale. Si rrjedhojë, ato modifikojnë ndjeshëm sistemet partiake në të cilën ato shfaqen. Së dyti, edhe kur partitë e reja nuk janë të suksesshme për t'u bërë aktorë qendrorë, p.sh., në politikat qeveritare, ato me pranimin e tyre kanë një ndikim në konkursin zgjedhor. Së treti, grupet që konsiderojnë formimin e një partie të re nganjëherë kërcënojnë ekzistencën e partive ekzistuese. Ata i detyrojnë këto të fundit që të miratojnë politika që ata do të preferonin të mos i kishin adresuar. (Hug, 2001, p.2). Në këtë artikull do të studiohen qasjet e ndryshme teorike të formësimit të partive politike.

Përpara se të analizojmë qasjet për formimin e tyre duhet të përmendim se përkufizimi për partitë e reja politike është i ndryshëm. Në literatura të ndryshme parti të reja quhen partitë të cilat nuk i përkasin konfliktit të ndarjeve të Lipset dhe Rokan, ose parti të krijuara së fundmi, ose parti të cilat kalojnë nga pozitat opozitare në pozita të partive që qeverisin së fundmi. (Deschouewr, 2004: 1-2) Gjithashtu, termi “partitë e reja” mbulon një sërë organizatash politike që kanë origjinë mjaft të dallueshme. Në këtë kategori mund të përfshihen parti që rezultojnë nga bashkimi i dy ose më shumë partive. Gjithashtu, mund të përfshihen parti të cilat janë formuar nga anëtarë të partive ekzistuese. Por, mund të përfshihen edhe parti të cilat janë formuar nga anëtarë të cilët nuk kanë qenë anëtarë të partive ekzistuese. Dhe gjithashtu, mund të përfshihen edhe partitë që rezultojnë nga aleancat elektorale. Por, partitë e reja në dy nga këto katër kategori janë thjesht parti ekzistuese të cilat janë riorganizuar. Ndërsa dy nga këto kategori nënkuptojnë sfidues të rinj në skenën elektorale, dy të tjerat (aleancat elektorale dhe bashkimet) nuk janë të tilla. Partitë e formuara nga anëtarë të rinj si dhe nga fraksionet në fakt shfaqen si protestë ndaj partive ekzistuese të cilat ato synojnë t'i influencojnë ose t'i sfidojnë.

Në vijim të përkufizimit për partitë e reja politike duhet përmendur se pavarësisht larmisë së përkufizimeve nga autorë të ndryshëm të rëndësishme janë veçanërisht përkufizimet që theksojnë dimensionin e anëtarëve dhe drejtuesve në partinë politike për herë të parë. Sipas autorit Simon Hug partia e re politike përcaktohet *‘si një organizatë vërtet e re që emëron, për herë të parë, kandidatë në një zgjedhje*

të përgjithshme në asamblenë përfaqësuese të sistemit’. (Hug, 2001, p.14–15). Allan Sick përcakton partitë e reja politike *‘si parti që nuk janë pasardhëse të asnjë partie parlamentare të mëparshme, kanë një emër dhe strukturë të re dhe nuk kanë ndonjë figurë të rëndësishme nga politika e kaluar demokratike midis anëtarëve të tyre kryesorë*’. (Sikk, 2005, p.399). Sipas autorëve Barnea – Rahat, *‘ne përcaktojmë një parti të re si një parti që ka një etiketë të re dhe që jo më shumë se gjysma e kandidatëve të saj kryesorë (kryesori i listës së kandidatëve ose rrethe të sigurt) vijnë nga një ish-parti e vetme*’. (Barnea – Rahat, 2011, p. 311).

Referuar autorit Allan Sick i cili bën një analizë të tipologjisë së Lucardie (2000) mund të thuhet se ekzistojnë dy tipe të partive të reja politike. ‘Prolokutorët’ të cilët nuk janë të lidhur me një ideologji të caktuar por synojnë të përfaqësojnë një çështje ose interes të veçantë në shoqëri. Kjo tipologji mund të përfaqësohet përgjatë dy përmasave. E para, të konsiderohet nëse një parti e re ka një motivim ideologjik të fortë ose jo. Disa mund të kenë të rrënjosura në një set politikash mjaft kohezive dhe gjithëpërfshirëse që ata dëshirojnë të ndjekin kur janë në qeveri; parti të tilla hyjnë në kategori të pastruesve dhe profetëve. Ato ndryshojnë nga njëra-tjetra veçanërisht duke u bazuar në atë nëse ideologjia që i motivon ato është tashmë por është përfaqësuar shumë varfër nga partitë politike tradicionale (purifikuesit) ose nëse është e re (profetët). Parti të tjera paraqesin sete më të limituara ose më pak kohezive për sa i përket propozimit të politikave. Prolokutorët veçanërisht adresojnë një çështje të veçantë ose interesa të cilat kanë interes në një shoqëri të caktuar dhe nuk është përfaqësuar nga aktorët tradicionalë. (Sick, 2011, p. 466).

Kërkimi shkencor për partitë politike të reja filloi të bëhej më i rëndësishëm në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të. Rëndësia e tyre ishte domethënëse në vitet 1980, por tekstet relevante filluan të shfaqen rreth një dekadë më vonë. (Sarovec, 2019, p.56). Studimi i partive të reja politike ka ecur nëpër një rrugë të gjatë. Kërkuesit shkencorë kanë studiuar varietetin e partive të reja politike duke filluar me partitë e gjelbra dhe partitë e majta libertariene (p.sh Kitschelt, 1988; Muller-Rommel, 1985, 1993), partitë e krahut të djathtë populist dhe anti-migracion (e.g. Golder, 2003; Ignazi, 1992; Jackman and Volpert, 1996; Kitschelt, 1995; Van der Brug et al., 2005), partitë antististem (e.g. Abedi, 2002), dhe partitë rajonaliste (e.g., De Winter and Tursan, 1998). (Selb dhe Pituctin, 2010, p.147-170).

Lidhur me shfaqjen e partive politike të reja referuar autorit Deschouwer bëhet dallimi mes tre grupeve të partive të reja në bazë të origjinës së tyre gjenetike. Pothuajse të gjitha sistemet e partive europiane panë shfaqjen e partive të gjelbra në fund të viteve 1980 apo fillim të viteve 1990, të cilat morën statusin qeveritar në Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali dhe Finlandë dhe që përbëjnë grupin e parë. Grupi i dytë përbëhet nga partitë e reja radikale të djathta, por sipas Deschouwer ky grup është shumë heterogjen në përbërjen e tij. Grupi i tretë përbëhet nga partitë rajonale, të cilat dolën në Itali, Belgjikë, Spanjë dhe Britani dhe morën pjesë në

qeveri në Belgjikë, Itali dhe Spanjë. Këto tre grupime nuk përfaqësojnë të gjitha partitë e reja politike që janë shfaqur, pasi pas viteve '90 rënia e regjimit komunist në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore i bënte të gjitha partitë e krijuara parti të reja. Gjithashtu, edhe rënia e sistemit partiak të vjetër në fillim të viteve '90 në Itali bëri që të lindin parti të reja ku një prej tyre ishte Forza Italia. (Deschouwer, 2004: 5) Gjithashtu, edhe pas krizës financiare të vitit 2008 që përfshiu vendet e Evropës Perëndimore dhe jo vetëm kemi formësimin e partive të reja kryesisht të partive radikale të djathta të cilat e vendosin theksin tek kundërshtimi i emigrantëve apo minoriteteve.

Për sa i përket shfaqjes së partive të reja politike ashtu si edhe për partitë tradicionale duhet theksuar që qasjet për formësimin e tyre janë nga poshtë-lartë dhe nga lartë-poshtë. Partitë themelohen në dy mënyra: nga elita shoqërore që mbledhin për rreth tyre një grup të përkrahësve me ndikim që të mbrojnë pozitat e tyre, apo me qytetar që kërkojnë mbështetjen e personave me mendim të njëjtë në mënyrë që të arrijnë një ndryshim politik apo shoqëror. Në rastin e parë, më shumë është një qasje nga lart-poshtë për ndërtimin e partisë, siç ka qenë rasti me partitë e para liberale të cilat ishin të bazuara në komisionet zgjedhore të formuara lirshëm që aplikonin për përfaqësim parlamentar. (Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow, 2013, p.68). Në rastin e dytë kemi të bëjmë me qasje nga poshtë-lartë ku kërkesat dhe organizimi bëhen nga grupe me identitet të qartë të cilat kanë komponentin e organizimit për të realizuar përfaqësimin e interesave të tyre.

Në literaturën për shfaqjen e partive të reja, mund të dallohen afërsisht tre qasje. Së pari, një qasje institucionale-formale (sistemike) në të cilën autorët përqendrohen në veçoritë sistimore siç janë ligjet dhe pragjet zgjedhore, kërkesat për regjistrim ose financimin e partive publike (Harmel dhe Robertson 1985; Hug 2000). Nga këndvështrimi sistematik mund të argumentohet se karakteristikat më pak ose më shumë formale institucionale të një sistemi partiak ndikojnë në shancet që partitë e reja të dalin. (Selb and Pituctin, 2010, p. 148-149). Katz dhe Mair tregojnë qartë se konkurrenca e kufizuar e partisë mund të krijojë një dritare që mundëson shfaqjen e partive të reja: *"Një thirrje e veçantë që duket e përbashkët për shumë parti të reja dhe që duket veçanërisht e efektshme në mobilizimin e mbështetjes është kërkesa e tyre për të' Thyer Mykun 'e partive të themeluara [...] Partitë e kartelit shpesh janë duke ofruar pa dashje municion me të cilin protestuesit e rinj të së djathtës mund t'i kryejnë më me efikasitet luftërat e tyre "*. (Katz and Mair, 1995, p. 24). Në këtë qasje mund të themi se ekzistenca e sistemit proporcional rrit mundësitë e partive të reja për të hyrë në parlament. Në një sistem joproporcional qytetarët nuk synojnë të votojnë për partitë politike, sepse ato e dinë që vota për një parti të vogël është njësoj si ta humbasësh. (Gallagher, Laver, and Mair, 2001, p. 323). Harmel dhe Robertson me të vërtetë zbulojnë se faktorët sistemikë që mund të pengojnë suksesin e partisë së re nuk pengojnë formimin e partisë së re. *"Ironikisht, ato sisteme që kanë prodhuar numrin më të madh të partive të reja*

kanë më pak gjasa të shpërblejnë ato parti me vota dhe vende” (Harmel dhe Robertson 1985: p. 517). Gjetjet e tyre nxisin shpresën paradoksale që konkurrenca e kufizuar e partisë në aspektin e kontestueshmërisë dhe cënueshmërisë krijon bariere për hyrjen në parlament të partive të reja politike ndërkohë që rrit mundësinë për shfaqjen e partive të reja. Për këtë arsye, Harmel dhe Robertson sugjerojnë të mendojnë për partitë e reja që bien në dy kategori: partitë kandidate që kanë perceptimin se ato mund të jenë partitë të suksesshme elektorale dhe partitë promovuese që kuptojnë se shanset e tyre për sukses zgjedhor nuk janë shumë të larta, por që dëshirojnë të sjellin vëmendjen në një çështje apo shkak të veçantë.

Së dyti, kemi një qasje sociologjike për shpjegimin e shfaqjes së partive të reja politike e cila fokusohet në transformimin e strukturave të ndarjes ose ndryshimeve në orientimin e vlerave të qytetarëve (Inglehart 1997, Lipset dhe Rokkan 1967) në një përpjekje për të shpjeguar modelet e votimit dhe forma të tjera të (mos) pjesëmarrjes politike. Lidhur me këtë qasje mund të themi se votuesi ka një rol të rëndësishëm. Nëse kemi të bëjmë me ‘votuesin në dispozicion’ i përkufizuar si një votues i cili është i gatshëm të rishikojë dhe përfundimisht të ndryshojë preferencën e partisë së tij, kjo mund të ofrojë një nxitje për partitë e reja politike që të dalin. Këtu duhet përmendur se një faktor i rëndësishëm është gjithashtu homogeniteti i shoqërisë. Harmel dhe Robertson gjejnë një marrëdhënie pozitive midis heterogjenitetit të një shoqërie të caktuar dhe numrit të partive të reja. (Harmel dhe Robertson, 1985, p. 515). Po ashtu edhe sipas autorit Simon Hug vendet të cilat janë homogjene në lidhje me fenë dhe gjuhën japin një numër më të vogël çështjesh të reja, ndërkohë që vendet pluraliste ose gjysmëpolare lejojnë një mori interesash të politizuara dhe rrjedhimisht rrisin numrin potencial të çështjeve të reja. (Hug, 2001, p.95) Po ashtu, problemet ekonomike, të matura nga shkalla e papunësisë dhe rritjes, ka gjasa të krijojnë çështje të reja, ose t’i bëjnë ato më të shquara. Nivelet më të larta të papunësisë rrisin problemet për grupe të caktuara të një shoqërie, ndërsa normat e larta të rritjes shpesh zvogëlojnë këto probleme të njëjta. Pra, sipas kësaj qasje nëse çështjet e reja janë të rëndësishme, partitë e reja dalin shumë më shpesh dhe nëse do t’i referoheshim autorit Simon Hug, si një nga autorët më në zë të partive të reja politike çështjet e reja kanë të bëjnë me treguesit ekonomikë, madhësinë e popullsisë dhe karakteristikat e shoqërisë. (Hug, 2001, p. 120). Gjithashtu, lidhur me formimin e partive politike sipas kësaj qasje duhet theksuar se në shumë vende evropiane dhe anglo-amerikane, post-industrializmi shtoi një dimension të ri të diversitetit socio-politik: post-materializmi kundrejt materializmit (Inglehart, 1977, 1981). Post-materializmi është përmendur shpesh si një kontribues i mundshëm për formimin e partive të reja për të paraqitur çështje të reja, kryesisht shqetësime mjedisore (Wolinetz, 1979; Burklin, 1982). (Harmel and Robertson, 1985, p. 502-503). Bazuar në analizën e kushteve të nevojshme, formimi i partive politike të reja mund të gjurmohet nga ndërveprimi i tre elementëve: 1) besimi paraparak i partive ekzistuese se kanë të bëjnë me një sfidues

të fortë. Ky besim nuk mund të jetë shumë i lartë në mënyrë që partitë e reja të shfaqen. 2) Besueshmëria e sfiduesve të dobët. Nëse kostot e formimit i tejkalojnë përfitimet që ky sfidues i dobët pret të marrë, ky sfidues nuk do të formojë parti të re. 3) Gjasat që partia ekzistuese do të refuzojë kërkesat e forta. Pra, janë këto tre elementë që ndërveprojnë dhe vendosin për formimin e partive të reja. (Hug, 2001, p.53-54).

Një qasje e tretë, për formimin e partive politike e shpjegon origjinën e tyre duke u fokusuar në strukturën e mundësive politike, kërkon sqarimin për shfaqjen e partive të reja në zhvillimet më të menjëhershme dhe të përkohshme brenda sistemeve të partive, shpesh duke parë nivelin e polarizimit ose konvergencës së partive politike. Kjo qasje do të thotë që zvogëlimi i dallimit mes partive politike për sa i takon ideologjisë, krijon hapësirë për t'u përdorur nga partitë e reja veçanërisht ato të skajeve ekstreme por nuk shpjegon shfaqjen e partive më të moderuara dhe centriste. (Krouwel and Bosch, 2004, p. 3). Autorët Krouwel dhe Bosch citojnë autorin Bartolini kur shprehet se *“në konkurrencën e përsosur zgjedhore partitë supozohet të konvergojnë drejt votuesit mesatar dhe në fund ofertat e tyre do të jenë pikërisht të njëjta”*. (Bartolini 2000, p.34). Për të sqaruar formësimin e partive të reja politike ata shpjegojnë se rënia e dallueshmërisë së partisë zvogëlon konkurrencën duke kufizuar vendosmërinë, shkallën në të cilën votuesit mund të dallojnë dallimet partiake. Mungesa e dallueshmërisë së dukshme të partive e bën vendimin e votuesit të vështirë, apo madje edhe të pakuptimtë. Ajo gjithashtu mund të çojë që votuesit që kërkojnë (partitë e reja dhe më radikale) që mund të dallohen ideologjikisht ose programatikisht. Prandaj sipas autorëve Krouwel dhe Bosch pritet që konvergjenca midis partive kryesore politike të rrisë shanset për shfaqjen e partive të reja politike. (Krouwel and Bosch, 2004, p. 6).

Në vijim të qasjeve të mësipërme për formësimin e partive të reja politike, të cila e vënë theksin tek veçoritë sistemore, tek ndarjet sociale në shoqëri dhe dalja e çështjeve të reja për përfaqësim nga partitë politike, apo tek qasja e mundësisë politike duhet përmendur edhe ‘projekti i të resë’ si arsye e rëndësishme për formësimin e partive politike e trajtuar nga autori Allan Sick. Për rastet e krijimit të partive të reja për shkak të ‘projektit të të resë’ theksi vendoset tek besueshmëria për këtë parti për shkak të mospërshtimit të mëparshme në politikë, të qenit të rinj dhe të mos pasjes së lidhjeve me raste të abuzimit me pushtetin. Në shumë raste argumentohet kjo tezë duke u mbështetur edhe tek cilësitë e drejtuesit të partisë. Po ashtu, siç përmendet nga autori Allan Sick në artikullin e tij e reja si një formulë fituese për partitë e reja politike, pjesë e ligjërimit për raste të tilla të partive politike janë akuzat për mbajtësit e pushtetit qeverisës për dështime si dhe korrupsion. Alternativat që ofrohen nga parti të tilla politike mbështeten tek e reja, tek formulat për anti-korrupsion si dhe anti-establishment por që asnjëra nuk përbën një ideologji të re dhe as më pak nuk është e lidhur me ndarje sociale të mëparshme të injoruara.

Si përfundim mund të thuhet se studimi i partive të reja politike është i rëndësishëm për arsye të rëndësishme të tyre si aktorë në demokraci. Përkufizimi i partive të reja politike ka qenë i ndryshëm në kontekste të ndryshme, por një emërues i përbashkët i tyre është se janë parti të cilat formësohen për të sfiduar një sistem partiak të konsoliduar ose që ka një traditë të gjatë të formimit dhe veprimit politik si dhe në literatura të ndryshme teza dominante për etiketimin e tyre si parti të reja është të qenit të ri, të papërfshirë më parë politikisht të drejtuesit dhe anëtarëve. Gjithashtu, duhet përmendur që në këtë artikull në përpjekje për të analizuar rrymat e ndryshme të mendimit për formësimin e partive të reja politike, nga studimet mund të precipitohet në tre qasje ajo sisteme, sociologjike si dhe e konkurrencës politike. Një qasje tjetër e artikuluar nga autori Allan Sick është thesht projekti i të resë si arsye e krijimit të këtyre partive politike pa ofruar ideologji të re ose përfaqësim të ndryshimeve shoqërore.

BIBLIOGRAFI

- Allan Sick, (2011), Newness as a winning formula for new political parties, *Party Politics*, 18(4), 465–486, University College London, UK, DOI: 10.1177/1354068810389631
- Krouwel, A., & Bosch, O. (2004). *Explaining the Emergence of New Parties: Cynical Citizens and the rise of populism: Paper presented at the workshop Kwaliteit van het leven en politieke attitudes. Methodologische vraagstukken en empirische analyses, at the Politicologenetmaal 2004.*
- Barnea, Shlomit – Rahat, Gideon (2011): Out with the Old, In with the „New“: What Constitutes a New Party? *Party Politics* 17(3): 303–320.
- Bartolini, Stefano (2000) , *The Political Mobilization of the European Political Left, 1860- 1980: The Class Cleavage*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Gallagher, Michael and Laver, Michael, and Mair, Peter (2001), *Representative Government in Modern Europe. Institutions, Parties and Governments*. New York: McGraw-Hill.
- Harmel R and Robertson JD (1985) Formation and success of new parties. *International Political Science Review* 6: 501–523.
- Hug, Simon (2001): *Altering Party Systems: Strategic Behavior and the Emergence of New Political Parties in Western Democracies*. University of Michigan Press.
- Katz and Mair, (1995). Changing Models of Party Organization and Party Democracy. The Emergence of the Cartel Party. *Party Politics* 1 (1):5-28.
- Kris DESCHOUWER, (2004) 1-2. New Parties in Government: A Framework for Analysis. *paper prepared for the ECPR Joint Sessions in Uppsala* 13-18 april 2004.
- Marrë nga: <http://http://www.politologischinstituut.be/PE2004/documents/11aKrouwelBosch.pdf>

Šárovec, Daniel. «Is the “new” always “new”? Theoretical framework problems of new political parties’ research: The Czech Republic experience» *Politics in Central Europe*, vol.15, no.1, 2019, pp.55-80. <https://doi.org/10.2478/pce-2019-0003>

Selb, Peter and Pituctin, Sandrine.(2010), Methodological issues in the study of new parties. Entry and Electoral success. *Party politics*, 16 (2), 147-170.

Sikk, Allan (2005): How Unstable? Volatility and the Genuinely New Parties in Eastern Europe. *European Journal of Political Research* 44: 391–412.

Wilhelm Hofmeister/Karsten Grabow. (2013), *Partitë politike, funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike*, Prishtinë: Konrad Adenauer Stiftung.

NDIKIMI I INFERIORITETIT, MJEDISIT AGRESIV DHE PAPJEKURIA MENDORE NË KRIMINALITETIN E TË MITURVE.

MSc Lira Spiro

*Ass. Pedagoge Departamenti i
Ekonomisë dhe Shkencave Sociale
Kolegji Universitar "Pavarësia"
Vlorë*

EM. Anila Fega

*Pedagoge Departamenti i Ekonomisë
dhe Shkencave Sociale
Kolegji Universitar "Pavarësia"
Vlorë*

Abstrakt

Shoqëria njerëzore, edhe sot në shekullin XXI të ekzistencës së saj, vazhdon të ketë krimin bashkëudhëtar të saj. Kriminaliteti si një dukuri shoqërore negative nuk është karakteristikë vetëm e popullatës së të rriturve. Shpeshherë edhe të miturit paraqiten si autorë të veprave penale. Duhet theksuar se zhvillimi i gjithanshëm fizik e psikik i personave të mitur karakterizohet nga një intensitet i lartë si për sa i përket rritjes së tyre ashtu dhe për sa i përket lëkundshmërisë lidhur me vlerat shoqërore, kjo për shkak të papjekurisë së tyre.

Në këtë punim trajtohet i mituri, kriminaliteti tek ta dhe arsyet pse të miturit në një moment të caktuar të jetës kanë marr vendimin për kryerjen e një veprë penale. Duke u fokusuar tek arsyet, bëhet lidhja logjike midis pretendimeve dhe justifikimeve për mbrojtje që ata kanë parashtruar në vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë përgjatë vitit 2020, si dhe teorive kriminologjike dhe shpjegimeve që ka bërë cdo filozof në mbështetje të teorive që kanë ngritur.

Fjalë kyçe: *I mitur, kriminalitet, shkaqet/arsyet, teoria nënkulturore, teoria e të mësuarit social, teoria e kontrollit social, teoria psikologjike.*

HYRJE

Sot është një fakt i pakontestueshëm se krimi është një problem themelor i shoqërisë moderne si dhe forma më e rëndë e cënimit të cilësisë së jetës së tij. Gjithmonë e më tepër të drejtat bashkëkohore po i kushtojnë një rëndësi të posaçme trajtimit të të miturit si autor i veprës penale. Ky trajtim ka si qëllim parësor risocializimin e të miturit dhe kompensimin e asaj çka është neglizhuar në formimin e tij, në mënyrë të tillë që ai të jetë një anëtar i dobishëm për shoqërinë. Gjithashtu, duke pasur parasysh moshën e tyre të re, ka më shumë shpresë për përmirësim, ndërkohë që neglizhimi në drejtim të përmirësimit mund të jetë në dëm të shoqërisë në të ardhmen.

Sot është një fakt i pakontestueshëm se krimi është një problem themelor i shoqërisë moderne si dhe forma më e rëndë e cënimit të cilësisë së jetës së tij. Një vëzhgim i situatës së përgjithshme tregon se krimi është në rritje të shpejtë. Në rritje edhe më të madhe është numri i të miturve përsëritës.

Të miturit gjithmonë e më tepër po përfshihen në vepra penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, gjithmonë e më tepër po preken nga sëmundjet moderne të të rinjve si narkomania, alkoolizmi, prostitucioni etj. Si rrjedhim lind domosdoshmëria e studimit të kësaj grupmoshe, për të evidentuar problematikat që i shoqërojnë dhe për të përcaktuar masa konkrete në drejtim të ndërhyrjeve efektive.

Në fillimin e shekullit të XX-të pati një levizje të gjërë në drejtim të marrjes së masave të posaçme ndaj të miturit¹, në ato raste kur ai ishte paraqitur si autor i veprës penale. Duke menduar se për shkak të moshës nuk e kupton rëndësinë e veprës dhe si rrjedhim është më pak i përgjegjshëm, të miturit i caktohej një sanktion thjesht duke ulur dënimin². Gjithsesi zhvillimet e mëvonshme treguan se me anë të këtyre masave nuk është arritur rezultati i duhur. Zhvillimet bashkëkohore orientohen në hartimin e masave të posaçme që duhet të merren ndaj të miturve duke parashikuar në raste të caktuara edhe një procedurë të re ndaj tyre. Në përcaktimin e veçorive të trajtimit të të miturve si autorë të veprës penale duhet t'i jepet përparësi analizave shkencore dhe praktike mbështetur në zhvillimet e fundit të shkencave si psikologjia, sociologjia, kriminologjia etj. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihen rezultate pozitive për risocializimin dhe riedukimin e të miturve.

Nëse do të ndaleshim në tërësinë e faktorëve që ndikojnë në këtë sjellje asociale të të rinjve, duhet bërë një klasifikim në:

1) *Faktorët e përgjithshëm kriminogjen* siç janë papunësia, urbanizimi, mjerimi social dhe varfëria, përplasja e mentaliteteve të ndryshme në shoqëri, gjendjet e përgjithshme konfliktuale në shoqëri, mungesa e perspektivës; Në fakt këta fak-

1 Person që nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe është nën 18 vjeç.

2 Marsida Xhaferri, kumtesë prezantuar në seminarin “Alternativat e dënimit me burgim”, Maj 2007.

torë ndikojnë si në kriminalitetin e të rriturve dhe atë të të miturve, kjo për vetë faktin se dhe i mituri është pjesë e shoqërisë, rritet në gjirin e saj për t'u shndërruar më pas në një njeri të dobishëm për veten dhe të tjerët.

2) *Faktorët që kanë të bëjnë me mjedisin* që e rrethon të miturin si: familja, shkolla, rrethi shoqëror, komuniteti. Këta faktorë njihen ndryshe edhe si faktorët sociologjik, pikërisht për shkak të ndikimit të madh social dhe kulturor me të cilin përballlet i mituri; Që i mituri të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme duhet që gjatë procesit të socializimit të mbështetet nga familja dhe shoqëria. Në këtë moshë krijohet personaliteti dhe njohja me vlerat ekzistuese të një shoqërie. Kur raporti i të miturit me këta aktorë është i vështirë apo paraqet probleme, përfshirja në kriminalitet është më e mundshme.

3) *Faktorët e grupit të tretë* janë ata, të cilët janë të lidhur ngushtësisht me vetitë *bio-psikologjike* të personit³ si zhvillimi fizik, puberteti, sëmundjet shpirtërore, inteligjenca, zhvillimi emocional etj.

TË MITURIT DHE VEPRAT PENALE NË VITIN 2020 NË VLORË. ⁴

Neni I Kodit Penal	Të dënuar	Çështje e pushuar	Femra	Përsëritës	Pa arsim	Me arsim	Me gjobë	Deri në 5 vjet	Aplikim I nenit 59/a	Aplikim I nenit 63
134	5		1			5		5		1
139	4					4		4		
290	1					1		1	1	
291	6					6		6		1
305		2	2			2				

Duke analizuar tabelën e mësipërme vërejmë se gjatë vitit 2020 janë dënuar 16 të mitur dhe është pushuar çështja për dy të mitura femra të cilat akuzoheshin për kallëzim të rremë. Të miturit janë dënuar për vepra penale si Vjedhja (neni 134 I K.Penal); Vjedhja me dhunë (neni 139); Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor (neni 290); Drejtim I automjetit në mënyrë të parregullt (neni 291) dhe Kallëzim I rremë (neni 305).

Ajo që vihet re është se të miturit ndjekin arsimin 9 vjeçar ose atë të mesëm dhe arsyet që I kanë çuar të rinjtë të kryejnë veprat penale si vjedhja, kanë qënë

3 Vllado Kambovski, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Sh.B “Furkan ISM”, - Shkup, 2006, 1083

4 Statistika të marra nga Sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

nga shoqëria dhe mjedisi I gabuar ku janë gjendur për momentin. Në një vendim theksohej ndër të tjera se "...nuk doja të vidhja por atë natë ishim mbledhur më një grup shokësh, shumicën nuk e njihja dhe për të treguar që isha I fortë dhe mund të rrija në grup me ta duhet të vidhja tabakinon që ndodhej aty afër."

Në vendime të tjera, të rinjtë shprehen se nuk kanë mundësi ekonomike dhe të shpërfillur nga pjesa tjetër e shoqërisë, gjetën si zgjidhje për të treguar se janë të aftë të bëjnë gjëra "prej të forti".

TEORIA NËNKULTORE

Variant tjetër I teorisë së strukturave sociale⁵ është teoria e nënkulturave. Përfaqësuesi më në zë I saj është Albert Cohen. Kjo teori është zhvilluar rreth viteve '50 dhe është bazuar në studimin e kulturës së bandave në Chicago. Për Cohenin, bandat ishin një nënkulturë me vlera të ndryshme nga vlerat e përgjithshme amerikane që dallonte nga fjalori, besimet e brendshme të anëtarëve, mënyra e veçantë e veshjes dhe e veprimt të anëtarëve të bandës⁶. Personat që I përkasin një nënkulture të tillë kanë ide dhe vlera të ngjashme. Ata mblidhen dhe qëndrojnë së bashku për të mbështetur njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, shumë prej të rinjve krijojnë grupe ose banda adoleshente dhe kryejnë vepra penale. Sipas Cohen, sjellja e grupeve të tilla është e drejtë për nga standartet e nënkulturës, por është e gabuar për kulturën e gjerë të popullsisë.⁷

Njerëzit e shtresave të ulëta të shoqërisë, sidomos të rinjtë, provojnë tensione për shkak se janë të shmangur nga shoqëria tradicionale. Të rinjtë e shtresave të ulëta dëshirojnë ndryshimin e mënyrës së tyre të jetesës. Një pjesë përpiqen dhe I arrijnë rezultatet e dëshiruara, por pjesa më e madhe nuk I ka këto mundësi. Në pamundësi për të arritur sukseset, ata zhvillojnë një mënyrë alternative jetese me qëllim që të ndihen të rëndësishëm dhe të suksesshëm. Fatkeqësisht, kjo metodë mund t'I përfshijë ata në sjellje josociale e deri në krime.

Cohen e shpjegon kriminalitetin me mundësitë e pakta që kanë shtresa të caktuara të shoqërisë për të realizuar dëshirat e tyre, me mangësitë që kanë familjet e shtresave të varfëra të përgatisin fëmijët e tyre me aftësi për të arritur sukses në jetë dhe me pamundësinë që kanë fëmijët e shtresave të mesme dhe të larta të shoqërisë. Kështu, ndrydhja e shkaktuar nga statusi I familjes dhe mosarritja e nivelit të klasës së mesme kultivojnë nënkulturën e krimit.

Teoria e Cohen-it, ndonëse e përafërt me atë të Mertonit, ndryshon pasi Cohen

5 Sipas teorisë së strukturës sociale, kriminaliteti shpjegohet me strukturën sociale të një grupi të caktuar. Krimi shpjegohet me strukturën sociale të një grupi të caktuar. Krimi konsiderohet dukuri e shtresave të ulëta të shoqërisë.

6 Muncie, J.: Subculture, bot. në "The sage Dictionary of Criminology", Sage, 2001, f. 296-297

7 Skerdilajd Kurti, Metodatat e studimeve kriminale, Cikël Leksionesh, fq. 87

I jep rëndësi rolit të shkollës dhe shoqërisë. Sipas tij⁸, fëmijët e klasës së ulët nuk ndihen mirë në shkollë dhe ndrydhen, për shkak të kërkesave të saj të larta për të punuar shumë, vlera këto që janë tipike të klasës së mesme. Duke mos qënë në gjendje të arrijnë këto vlera dhe të kenë rezultate të mira, këta fëmijë kthehen në nënkulturën e bandave që të ndihen të respektuar. Sipas tij, edhe kur të rinjtë kryejnë vjedhjen ato I bëjnë më shumë për emocione sesa për arsye ekonomike.

Sikurse teoritë e tjera sociologjike, teoria e Cohen-it është kritikuar për shkak të supozimit të tij se krimi është produkt I shtresës së ulët të shoqërisë dhe anashkalon shtresat e mesme. Gjithashtu, supozimi I Cohen se shume krime nuk kryhen për shkaqe ekonomike, po për shkak të ndrydhjes që provojnë të rinjtë në shkollë, është kritikuar.

TEORIA E KONTROLLIT SOCIAL

Teoria e kontrollit social nënkupton se njerëzit që kryejnë vepra penale, nuk kanë mungesë morali, por morali i tyre është i ndryshëm nga ai i pjesës tjetër të shoqërisë. Bashkëjetesa sociale dhe psikologjike me personat e tjerë, me institucionet dhe komunitetin e tyre ul mundësinë e krimeve në rradhët e tyre. Rëndësi kanë marrëdhëniet me familjen, mësuesit, punonjësit, shokët dhe marrëdhëniet personale⁹. Sa më shumë kujdes të tregohet për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, punën, arsimimin etj., aq më i vogël është rreziku që një person të përfshihet në aktivitete jashtëshkollore, aq më pak mundësi ka të përfshihet në krim.

Teoritë e kontrollit social I kushtojnë vëmendje kontrollit në famlje, duke nënvizuar ndikimin e familjes me probleme në kriminalitet; rolit të nënës te fëmija, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, strukturës së familjes dhe trajtimit që u bën familja djemve dhe vajzave. Lidhjet e shkollës me kriminalitetin janë element tjetër i trajtuar nga teoria e kontrollit social; moshatarët, fqinjët dhe mjedisi i punës janë elemente të rëndësishëm që ndikojnë në kriminalitetin e te miturve dhe jo vetëm.

TEORIA E TË MËSUARIT SOCIAL.

Teoria e të mësuarit social është një nga teoritë me bazë psikologjie¹⁰. Në jetën e përditshme njerëzit kryejnë veprime të ndryshme, një pjesë e të cilave janë natyrale ose instiktive, ndërsa pjesa tjetër të mësuar. Njerëzit nuk lindin të ditur, por ata mësojnë të sillen nëpërmjet një procesi të gjatë. Sjelljet e njeriut që në fëmijëri janë të lidhura me sjelljet e njerëzve që e rrethojnë atë. Modelet e sjelljes mund të mësohen duke vëzhguar modele në botën që rrethon personin. Fëmijët që

8 Barkas, S., Criminology, A Sociological Understanding, vep. E cituar, f.185.

9 Hysi, V., Kriminologjia, Botimet Kristalina, 2010

10 Këto teori përpiqen të shpjegojnë krimin me crregullimet e aspektit psikologjik.

janë agresivë kanë prindër që përdorin taktika agresive ose janë rritur në mjedisë ku agresiviteti është i pranishëm.¹¹

LIDHJA MES ARSYEVE REALE TË DHËNA NGA TË MITURIT QË KANË KRYER NJË KRIM DHE ARSYEVE QË PËR- FAQËSUESIT E TEORIVE TË SIPËRCITUAR.

Nga procesverbalet e psikologëve që kanë qënë të pranishëm në seancat gjyqësore, arsyeja primare që i ka çuar në krim të miturit është papjekuria e të miturve. Duke e krahasuar me teorinë nënkultore, gjejmë lidhje me faktin se dhë të miturit në Vlorë kishin dëshirën për t'ju bashkuar bandave të vogla për faktin se ndiheshin më të arrirë dhe kjo për shkak të mos angazhimit serioz në procesin mësimor, por jo gjithmonë dhe vetëm për shkak dhe të faktit se vinin nga shtresa të ulëta të shoqërisë.

Në vijimësi të studimit, arsye tjetër që lidhet dhe me teorinë e kontrollit social që i korrespondon vëmendjes që vjen nga familja. Prindërit duke u fokusuar më shumë në punët e tyre për të siguruar të ardhura për fëmijët, harrojnë të jenë pranë rritjes së fëmijëve duke brumosur në mendjen e fëmijëve shembullin e të mirës.

Referuar teorisë së të mësuarit social, e mitura femër që kishtë bërë kallëzim të rremë për një djalë duke e akuzuar për kryerje të marrëdhënieve seksuale me të mitur, gjatë bisedës me psikologun nxori në skenë një temë tjetër sensitive siç është krijimi i një lidhjeje me detyrim vetëm sepse familja nuk pranon që fëmija të ketë një pëlqim pa krijuar direct një marrëdhënie që të përfshihen dhe familjet. Mjedisi ku rritesh, shembulli që shikon në përditshmëri, ndikoi dhe në shumë vepra të tjera që kishin kryer të miturit, duke u ndikuar nga modeli i keq dhe agresiv që ndeshin rreth ambientit ku rriten.

PËRFUNDIME

Të ndalosh të miturin të kryejë një vepër penale nuk është vetëm t'i thuash së është e gabuar, duhet t'ja tregosh. Në një mjedis shoqëror si në Shqipëri, ku krime ndodhin dhe transmetohen në cdo moment në television, është e vështirë ta mbash larg vëmendjen e tyre drejt këtyre ngjarjeve. Ajo që sugjerohet është përveç kujdesit dhe bisedave fillimisht nga prindërit, nga mësuesit dhe sigurisht nga shoqëria, të tregohet shembulli i mirë në çdo veprim para tyre. Veprimet kriminale mund të ndikohen nga shpeshhtësia, intensiteti, kohëzgjatja e sjelljeve në kundërshtim me ligjin dhe nga autoriteti me popullaritet që mbart personi që paraqet një sjellje të tillë.

Problemet lidhur me të miturin nuk janë thjesht të karakterit juridik, por edhe

11 Williams C., Textbook on criminology, f. 278.

të karakterit social. Prandaj në trajtimin e tyre kërkohet jo vetëm pjesëmarrja e aktorëve institucional, por edhe atyre shoqërore si familja, shoqëria, komuniteti. Zhvillimi i drejtësisë për të mitur nuk mund të kufizohet thjesht në përfshirjen e nocioneve të reja, por edhe në zbatimin e tyre në praktikë, çdo ndryshim nuk duhet thjesht të mbetet në fazën e rekomandimeve, por të shoqërohet me energji shtytëse pozitive për të ecur përpara.

Për ta përmbyllur, arsyet që çojnë në krim janë të shumta dhe jo vetëm në arsyet që jepen në teoritë kriminologjike të përmendura, megjithatë këto teori ishin shumë praktike dhe tregonin direkt lidhjen e mjedisit, familjes, shoqërisë dhe nivelit kulturor që ata marrin gjatë jetës. Të miturit kanë tendencën të imitojnë dhe të zhvillojnë në vetvete atë që u serviret më shpesh. Duke patur kontakte me njerëz të prirur për të kryer krime, ata favorizojnë këto sjellje, proces ky që ndodh dhe në të kundërt, njerëz me prirje për të kryer krime, mësojnë nga njerëzit me të cilët kontaktojnë.

BIBLIOGRAFIA

Hysi, V., Kriminologjia, Botimet Kristalina, 2010

Skerdilajd Kurti, Metodatat e studimeve kriminale, Cikël Leksionesh, fq. 87

Vllado Kambovski, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Sh.B “Furkan ISM”, - Shkup, 2006

Williams C., Textbook on criminology

Muncie, J: Subculture, bot. në “The sage Dictionary of Criminology”, Sage, 2001, f. 296-297

Barkas, S., Criminology, A Sociological Understanding, vep. E cituar, f.185.

Të dhëna statistikore nga vendimet e vitit 2020 për të miturit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

INTERNATIONAL LAW COMMISSION ARTICLES ON STATE RESPONSIBILITY AND COVID-19 PANDEMIC

Sara MAHILAJ

*Faculty of Economics and Social Sciences
Department of Law and Political Sciences
University College "Pavaresia" Vlora, Albania
e-mail: sara.mahilaj@unipavaresia.edu.al*

*"Every right implies a responsibility; Every opportunity, an obligation; Every possession, a duty."
- John D. Rockefeller -*

Abstract

The COVID-19 pandemic is still taking the lives of many people around the world. All aspects of life have been impacted, resulting in significant global damage. This pandemic has raised questions about whether China could be internationally responsible for the failure to prevent the spread of the virus or not. As a result, the focus of this study is on international law of state responsibility, as formulated by the International Law Commission in the 2001 Articles. It sheds light on the violation of an international obligation and the international potential consequences of this wrongful act. Furthermore, if found responsible, China is obligated to make reparation for the damage caused by its internationally wrongful acts through restitution, compensation, and satisfaction. So in that situation, I'm speaking from personal observation, given that it is an interesting case with no precedents.

Key words: *COVID-19, State Responsibility, World Health Organization, International Compensation, Internationally Wrongful Act.*

HYRJE

Pandemia botërore nën emrin e COVID-19, përveç ndikimit që solli në çdo fushë të jetës, solli edhe diskutime të shumta të cilat lidhen pikërisht me pikënisjen e kësaj pandemie. Origjina e COVID-19 është një temë tepër sensitive, kjo për shkak të spekulimeve të ndryshme, nga krijimi i saj në një laborator në Wuhan, Kinë e deri te fakti nëse një shtet duhet të jetë ndërkombëtarisht përgjegjës që nuk mundi të merrte masat adekuate për parandalimin e përhapjes së virusit. Por, pavarësisht këtyre spekulimeve e dyshimeve sa njerëzore aq edhe juridike, rastet e para që vijnë pikërisht nga Kina mbeten një fakt real dhe i njohur. Kështu i gjithë tensioni dhe debati ndërkombëtar lidhet drejtpërdrejtë me Kinën dhe përgjegjësinë e saj ndaj komunitetit ndërkombëtar.

Shkelja e një detyrimi ndërkombëtar nga ana e një shteti përcakton, në kurriz të tij, konsequencën juridike të lindjes së përgjegjësisë ndërkombëtare. (Augusto Sinagra, 2019) Si pasojë, pyetja kërkimore e këtij punimi lidhet pikërisht me faktin nëse kemi shkelje të një detyrimi ndërkombëtar nga Kina, duke pasur kështu në fokus Artikujt e Komisionit ndërkombëtarë mbi përgjegjësinë e shteteve, kundrejt akteve ndërkombëtarisht të paligjshme. Ndaj, këtë temë kam vendosur ta analizoj nëpërmjet një pune kërkimore induktive. Ku problem kryesor i logjikës induktive është të përcaktohet vërtetësia apo pavërtetësia e një fakti duke ndjekur probabilitetin e konkluzioneve. (Stock, 2009)

SHKELJA E NJË DETYRIMI NDËRKOMBËTAR

Në komunitetin ndërkombëtar nuk është gjithmonë e lehtë të identifikosh se kush është në shkelje të ligjit ndërkombëtar. Kompleksitetet të cilat bëjnë një shtet të jetë përgjegjës për shkelje të një detyrimi ndërkombëtar mund të jenë të natyrave të ndryshme. Si pasojë, mund të lindin pyetje se cilat veprime saktësisht e bëjnë një shtet që të jetë përgjegjës.

Dispozitat e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar, e vitit 2001, mbi përgjegjësinë e shteteve ndaj akteve ndërkombëtarisht të paligjshme, flasin në realitet edhe për një të drejtë zakonore ndërkombëtare të pranuar gjerësisht. (Crawford, 2013)

Duke vlerësuar dispozitat e këtij artikulli, që në kapitullin e I të saj është e përcaktuar shprehimisht se përgjegjësia për çdo akt të paligjshëm i atribuohet shtetit (Neni 1) në rastet kur është e përcaktuar sipas të drejtës ndërkombëtare, si dhe kur përbën shkelje të një detyrimi ndërkombëtar. (Neni 2) (Commission, Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts, 2001)

Për të marr konkretisht në analizë pyetjen time kërkimore, Kushtetuta e Or-

organizatës Botërore të Shëndetësisë, në kapitullin XIV të saj ka të përcaktuar të gjitha rastet se kur një shtet duhet t'i raportoj çdo vit organizatës. Qartësisht e theksuar në Nenin 63-64 të saj, çdo pjesëtar do të sigurojë raporte statistikore dhe epidemiologjike; statistika këto, të rëndësishme, që kanë të bëjnë me rregullore, raporte zyrtare mbi shëndetin etj. (Assembly, 2006) Kjo përkon me detyrimin e Kinës ndaj organizatës për të raportuar në fillimet e saj rastet me COVID-19 në territorin e vet, gjë që të cilën nuk e realizoi. Duke mos raportuar për rastet në fillimet e saj (News, 2021), Kina rrezikoi përhapjen e virusit në masat që ndodhi, pa i dhënë kështu mundësinë WHO të zbatonte Nenin 21 të saj rreth karantinës dhe procedurat e tjera të krijuara për të parandaluar përhapjen ndërkombëtare të virusit.

Në mënyrë paralele kjo na dëshmon për shkelje të një detyrimi ndërkombëtar, shkelje e dispozitave mbi përgjegjësinë e shteteve ndaj akteve ndërkombëtarisht të paligjshme. Në pamundësi të ndalimit të përhapjes së origjinës së virusit, mund të sigurohej për ndalimin e përhapjes në masë pandemie. Si rrjedhojë, Kina si subjekt ndërkombëtar i atribuohet shkelja e kryer dhe duhet të mbaj përgjegjësitë përkatëse në sferën ndërkombëtare.

RIPARIMI I SHKELJES SË NJË DETYRIMI NDËRKOMBËTAR

Të gjitha shtetet e prekura nga pandemia mund të kërkojnë riparimin e shkeljes së një detyrimi ndërkombëtar ose eliminimin e konsekuencave të provokuara me qëllim për të rivendosur *status quo ante*¹. Kjo mund të konsistoj në: *rikthim, kompensim, kënaqje*.

- **Rikthimi:** Konsiston në detyrimin e shtetit lëndues për të rivendosur situatën në gjendjen e mëparshme në rastet kur është e mundur. (Neni 35, (Commission, Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts, 2001)
- **Kompensimi:** Kur shteti lëndues detyrohet të paguajë një shumë monetare që korresponдон me vlerën e çmuar të rikthimit në formë specifike, kur ky është i pamundur. Kësaj mënyre mund t'i shtohet edhe *zhdëmtimi* kur ky i fundit është i nevojshëm. (Neni 36, (Commission, Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts, 2001)
- **Kënaqje:** Është formë e riparimit që bëhet e mundur kur mënyrat e tjera nuk janë të mjaftueshme ose të përshtatshme për të zgjidhur çështjen. Mund të konsistojë në një pranim të shkeljes, një shprehje keqardhje, a falje zyrtare ose një modalitet tjetër i përshtatshëm. (Neni 37, (Commission, Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts, 2001)

¹ Nga latinishtja: *për të rikthyer gjendjen e mëparshme*.

Në rrethana të tilla, ku kemi një pandemi botërore, duke marrë në analizë secilën prej pikave të sipër përmendura është vështirë për të arritur në realizimin e tyre.

Në shembullin e rikthimit, për të vendosur gjendjen e mëparshme është totalisht e pamundur realizimi nga ana e Kinës. Pasi humbjet ekonomike, politike ashtu si edhe shume jetë njerëzish nuk mund të rikthehen. Edhe pse, sigurisht, mund të ketë shtete që pretendojnë rikthimin për humbjet ekonomike që kanë pësuar, në kushtet kur këto prapësime janë të mundura dhe në proporcion me dëmin e shkaktuar. Por ky rast paraqitet më tepër nën figurën e kompensimit. Duhet të kuptohet se këtu bëhet fjalë për humbje dhe dëme ekonomike të cilat Kina ka pamundësi efektive për t'i përballuar. Kompensimi në këtë rast kërkon dhe pranimin nga ana e Kinës të mosraportimit fillestar dhe se çdo efekt i mevonshëm erdhi si pasojë e saj. Gjë për të cilën vlerësoj se në bazë të kompleksitetit të çështjes ekonomike të vendeve të prekura nga pandemia, si dhe të qëndrimit të mbajtur nga Kina për këtë situatë, kjo e fundit nuk do të shprehet hapur për pranimin e “fajit”.

Për të kaluar më pas te pika e tretë, kënaqja. Kina mund të komunikoj një falje zyrtare, si dhe një pranim të situatës e cili doli nga kontrolli i saj, por pranimi në këtë rast do të sillte dhe detyrime të tjera për të, si rasti i kompensimit. Juridikisht do e lehtësonte shumë herë më shumë kërkesën e shteteve të prekura për një kompensim të mundshëm.

Kjo do të thotë se, për të gjitha arsyet, që kam konkluduar më lartë është e vështirë të kemi një pranim zyrtar të pranimin të shkeljes së një detyrimi ndërkombëtar nga ana e Kinës. Edhe pse kjo nuk e shmang dot përgjegjësinë e saj ndaj fakteve reale dhe se nuk mund të krijohen precedent abuzimi të këtij lloji dhe të mbeten pa gjykuar. Në sferën ndërkombëtare ajo mbetet përgjegjëse për mos raportimin e situatës në kohën e duhur, gjë e cila, do të krijonte mundësinë e çdo shteti për të marr masat e nevojshme në mos-kthimin e virusit në një pandemi globale.

KONKLUZIONE

E drejta ndërkombëtare aktuale nuk kërkon që nga shkelja e normës të shkaktohet domosdoshmërisht një dëm ndaj subjektit të lënduar. Ajo e konsideron një dëm në vetvete shkeljen e një detyrimi ndërkombëtar dhe kjo është e mjaftueshme për të provuar përgjegjësinë ndërkombëtare. Gjë që e bën akoma më të rëndë rastin e një pandemie dhe mos marrjen e masave për parandalimin e saj. Ndaj çdo subjekt ndërkombëtar i lënduar duke u bazuar në nenet e ILC, mund të shpreh se Kina kishte mundësi efektive për të raportuar përpara se virusi të përhapej e të kthehej në një pandemi globale.

Në këto kushte duke parë konfuzionin që krijohet për shkak të përhapjes globale të pandemisë, të ndryshimit rrënjësor që solli, ashtu si dhe “heshtjes ligjore” që i është bërë rastit të Kinës, mungesa e një praktike të prekshme krijon

mundësinë e konsideratave hipotetiko-analitike. Tashmë çështja mbetet të zgjidhet duke kërkuar një komunikim midis vendeve të komunitetit ndërkombëtar dhe Kinës, për të pranuar gabimet e veta të sferës ligjore, ose nga instancat gjyqësore ndërkombëtare, e cila do të mbaj qëndrimin e vet në varësi të pretendimeve të shteteve të prekura. Ajo që është e sigurt është se në një të ardhme të afërt do të detyrohet të artikulohet qëndrimi juridik, si nga Kina ashtu edhe nga shtetet e prekura nga kjo pandemi. Të gjitha këto mbeten për tu diskutuar dhe parë në të ardhmen.

REKOMANDIME

Duke qenë se që nga viti 2001 dispozitat e ILC për përgjegjësinë e shteteve ndaj akteve të paligjshme nuk kanë pasur asnjë rishikim, qëndoj me mendimin se duhet të bëhen përditësime për të qenë koherent me çdo të re që sjell e ardhmja. Në këtë rast duke shtuar sanksione ndaj shkeljeve ndërkombëtare, për të qenë më tepër të theksuara përpara së një çështje të shkoj para GJND apo GJNA.

Duhet të merren masa për detyrueshmërinë e raportimit të rasteve (sëmundje, -virus) që në fillesat e saj pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në mbrojtje të komunitetit ndërkombëtar. Të rishikohen nenet përkatëse në specifikimet terminologjike “raportim vjetor” duke shtuar edhe për “rastet fillestare”, ashtu si dhe ato “dyshuese”. Kjo për të shmangur përhapjen në masë të viruseve që mund të lindin në të ardhmen, duke marrë në analogji rastin e COVID-19, si dhe për të shmangur interpretime të ndryshme të tekstit ligjor.

Duhet të vazhdojnë studimet në lidhje me efektet negative ligjore që erdhën dhe që mund të vijnë si pasojë e COVID-19. Në këtë mënyrë për të shmangur vakumin e denoncimeve pa zgjidhje, siç ndodhi përgjatë vitit 2020, (pasi kishin një ndikim mjaft politik) dhe për të arritur në konkluzione të kristalizuara me arsyetim të konkluduar ligjor.

Referenca

- Assembly, W. H. (2006, October). *Constitution of the World Health Organization*. Aksesuar në: https://www.who.int/governance/eb/who_constitution_en.pdf
- Augusto Sinagra, P. B. (2019). *Lezioni di diritto internazionale pubblico*. Italy: Giuffrè .
- Commission, I. L. (2001). *Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts*. United Nations.
- Commission, I. L. (2008). *Draft Articles on Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts, with commentaries*. Aksesuar në: https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/9_6_2001.pdf

Crawford, J. (2013). *State Responsibility*. United Kingdom: Cambridge University Press.

News, B. (2021, February 14). *Covid-19 pandemic: China 'refused to give data' to WHO team*. Aksesuar në: <https://www.bbc.com/news/world-asia-china-56054468>

Stock, S. G. (2009). *Deductive Logic*. London: Kessinger Publishing, LLC. Informacioni Website i aksesuar më 04.07.2021.

Ç'RREGULLIMET MENDORE DHE KRIMINALITETI

MSc. Kristina XHAFAJ (DODI)

Student, Master Ekzekutiv në Kriminologji

Jurist, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Abstract

This paper analyzes the involvement of persons with mental health disorders in crime. The first studies on mental illness were given by Cesare Lombroso, a psychiatrist since 1862 in Pavia. Every person, with or without mental health illness, is at risk of engaging in criminal and anti-social behavior, but the study of people who associate these illnesses is done because they have one more cause that pushes them to get involved in crime. In this paper, the violent behavior of persons suffering from mental health diseases and aspects related to criminological theories will be studied in general. The main and most debatable issue addressed is the question: are people with mental disorders more dangerous than people who do not have these diseases?

Key words: *mental health disease, genetic factor, criminal liability, crime*

KUPTIMI I "Ç'RREGULLIMIT TË SHËNDETIT MENDOR"

Studimi i sëmundjeve të shëndetit mendor dhe dhënia e mësimeve lidhur me to, kanë filluar që në vitin 1862 në Pavia nga mjeku psikiatër Cesare Lombroso i cili në librin e tij që shënon dhe bazat e teorive biologjike të shpjegimit të kriminalitetit "*Njeriu kriminel (1876)*", bën një ndarje të kategorive të kriminelëve. Ndër të tjera, një nga kategoritë e kriminelëve është edhe krimineli epileptik, i semuri mendor, i çmenduri apo me shëndet mendor të dobët që janë të gjithë ata kriminelë që veprojnë pa ndonjë motiv, të shtyrë nga budallallëku ose nga fakti i

të qenit i çmendur.¹

“Ç’rregullim i shëndetit mendor” është ç’rregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme.²

Personat pa sëmundje të shëndetit mendor, sipas mendimit personal, janë po aq të dhunshëm sa edhe personat me këto sëmundje. Publiku më së shumti ka frikë nga dhuna që është e rastësishme, e pakuptimtë dhe e paparashikueshme.³ Duke u bazuar edhe në përditshmërinë tonë, kur kryhet një vepër penale nga një person që rezulton se vuan nga ç’rregullime mendore, media e transmeton këtë ngjarje deri në detajet më të vogla. Anëtarët e publikut pa dyshim e ekzagjerojnë forcën e marrëdhënies midis ç’rregullimeve mendore dhe dhunës, ashtu si edhe rrezikun e tyre personal nga të sëmurët e rëndë mendorë.⁴ Rastet më të mëdha të përdorimit të dhunës nga këta persona janë raste ku ata ngacmohen apo diskriminohen për shkak të gjendjes së tyre.

PËRGJEGJËSIA PENAL DHE MASAT PSIKO-SOCIALE.

Shpesh dëgjojmë se autorë të veprave penale kanë një çrregullim të shëndetit mendor që i ka çuar drejt kryerjes së saj. Tendencia më e madhe e legjislacioneve, njësoj si ai shqiptar⁵, është ulja e përgjegjësisë penale ose përjashtimi nga kjo përgjegjësi e këtyre personave. Ata, që në momentin e kryerjes së veprës penale, nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë veprën e as të kontrollojnë veprimet e tyre, në të drejtën penale konsiderohen të papërgjegjshëm.⁶

Përjashtimi i këtyre personave nga përgjegjësia penale nuk duhet të aplikohet, por mbajtja parasysh e faktorit çrregullues duhet të konsiderohet në dhënien e vendimit. Personat me këto sëmundje, të arrestuar për vepra me rrezikshmëri të ulët duhet të devijohen nga sistemi i drejtësisë penale, në sistemin e shëndetit mendor.⁷ Vendorsja e një personi që nuk ka qenë plotësisht i ndërgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës penale në një institucion të vuajtjes së dënimit sëbashku me

1 I gjithë paragrafi i referohet: S.Kurti, “Cikël leksionesh”, Tema 2, Master Ekzekutiv në Kriminologji, 2021.

2 Ligj nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, neni 3, pika 1.

3 H.Stuart, “Violence and mental illness: an overview”, Kanada 2003.

4 Po aty.

5 Neni 17 “Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore”, i Ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

6 K.Ukaj, “Faktorët kriminogjenë dhe shkaqet determinuese të tyre”, Revistë Studimore - Shkencore “Dardania”, Kosovë 2015, faqe 191.

7 S.Morse, “Mental Disorder and Criminal Justice”, Pennsylvania 2018, faqe 269.

autorë që kur kanë kryer vepra penale kanë qenë plotësisht të vetdijshëm është jo efektive. Pasi të ketë dëgjuar provat, një gjyqtar mund të urdhërojë që një person të marrë pjesë në terapi dhe/ose të marrë ilaçe, si kusht për të mos u trajtuar në spital dhe programe të tilla kanë qenë të suksesshme dhe duhet të zgjerohen.⁸ Vendosja e këtyre personave në një institucion të posaçëm për trajtimin e tyre, do të sjellë përfitime të mëdha për ta edhe pse kostot e trajtimit të tyre do të jenë të larta për t'u përballuar. Shpesh herë shtetet, për shkak të investimeve si në struktura, burime njerëzore dhe kohë zgjedhin t'i trajtojnë këta autorë brenda të njëjtës institucioni me autorë të tjerë, por programin e trajtimit e specializojnë në raport me nevojat e tyre. Ndihma për njerëzit që kanë sëmundje të rënda mendore është e dhembshur, e shtrenjtë dhe një nga investimet më të mira afatgjata që shoqëria jonë mund të bëjë.⁹

Një mungesë e theksuar në kodin tonë penal janë masat psiko-sociale. Realizimi i qëllimit kryesor për parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale nëpërmjet përdorimit të masave të tipit psiko-social, është më mirë nëse arrihet duke mënjanuar institucionet të mbyllura të vuajtjes së dënimit.¹⁰ Kur një person ka probleme të shëndetit mendor, si në rastin kur ka kryer një vepër penale, edhe në rastin kur mundësitë për ta kryer atë janë të shumta, vendosja e tij në një institucion të mbyllur sjellë rëndim të gjendjes së tij. Ashtu si me sëmundjet e rënda fizike, trajtimi i siguruar nga programet bamirëse ose qeveritare shpesh mund të ndihmojë një person të sëmurë rëndë të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në shoqëri.¹¹

Gjithashtu, një përfitim tjetër i devijimit të të dënuarve me ç'rregullime të shëndetit mendor nga sistemi i drejtësisë dhe vendosja e tyre në institucione të posaçme të trajtimit, do të sjellë ulje të popullimit të burgjeve. Burgjet janë vendi i gabuar për shumë njerëz që kanë nevojë për trajtim të shëndetit mendor, pasi sistemi i drejtësisë penale thekson parandalimin dhe ndëshkimin para trajtimit dhe kujdesit.¹² Qëllimi i dënimit është riedukimi dhe rehabilitimi i autorëve për t'u rikthyer në shoqëri, ndërsa në rastin e autorëve me probleme të shëndetit mendor qëllimi duhet të jetë shërimi i tyre dhe pastaj rehabilitimi.

Ç'RREGULLIMI I PERSONALITETIT DHE "ANA E ERRËT" E TIJ.

8 D.Kopel, "Facts about mental illness and crime", 2015.

9 Po aty.

10 K.Myftari, "Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore. Kriteri juridik në të drejtën penale", Disertacion Doktorature, Tiranë 2014, faqe 96.

11 D. Kopel, C. Cramer, "Reforming Mental Health Law to Protect Public Safety and Help the Severely Mentally Ill", Howard Law Journal 2015, Vol. 58 No. 3.

12 Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Shëndeti mendor dhe burgjet", faqe 3.

Sipas studimeve, një pjesë mjaft e madhe të autorëve të veprave penale ka një çrregullim të personalitetit në momentin e kryerjes së saj. Personaliteti është tërësia e karakteristikave të çdo individi të cilat tregojnë mënyrën e jetesës së tij në shoqëri.¹³ Pra, personaliteti është karakteri i personit në bashkëveprim me faktorët mjedisor. Nga një studim i bërë në burgjet e Iranit, rezultatet treguan se 87.3% e grave dhe 83.3% e burrave kishin një çrregullim të personalitetit në kohën e kryerjes së krimit.¹⁴ Çdo person ka një karakter unik, që e karakterizon atë dhe ndikimi i faktorëve mjedisor apo social përcakton sjelljen e tij, si kriminale ose jo. Një shembull i thjeshtë për të treguar se çdo person ka personalitetin e tij unik dhe ndikimi i faktorëve të jashtëm është i ndryshëm, në persona të ndryshëm është marrja në studim e dy personave që janë rritur në të njëjtin ambient social. Këta persona jo domosdoshmërisht reagojnë njësoj ndaj faktorëve të jashtëm. Ka raste të shumta ku një person, i një grupi shoqëror apo shpesh i edukuar në të njëjtin familje me një person tjetër, është përfshirë në sjellje kriminale. Kjo nuk do të thotë se edhe personi tjetër duhet të ketë sjellje kriminale dhe këtë e lidhim drejtpërdrejtë me personalitetin e çdo personi dhe mënyrën se si gjithsecili prej nesh i përballon ngacmimet e jashtme. Në një nga rezultatet e studimeve të Freud, neurolog austriak, thuhet se “Brenda personalitetit të çdo njeriu gjendet një pjesë e fshehur, e errët, normalisht e neutralizuar (ana e errët e personalitetit), por që nëse do të lirohej, do të na transformonte në kriminelë, vrasës mizore dhe keqbërës të rrezikshëm”¹⁵. Edhe pse e gjej të bazuar këtë përfundim, nuk jam plotësisht dakort se kjo anë e errët e personalitetit gjendet tek çdo njeri. Jo çdo njeri e ka këtë pjesë të errët të personalitetit e cila mund të lirohet dhe të na transformojë në kriminel. Duke e lidhur dhe me shembullin e dhënë, sipas Freud, të gjithë personat që jetojnë në një mjedis dhe ndikohen nga të njëjtët faktorë të jashtëm që i shtojnë të përfshihen në sjellje kriminale, do të ishin kriminelë. Kjo anë e errët e personalitetit ekziston vetëm tek disa persona dhe këta persona në momentin që bien në kontakt me faktorin e jashtëm ngacmues, e shfaqin atë.

TRASHËGIMIA DHE KRIMINALITETI.

Lidhja midis trashëgimisë dhe kriminalitetit ka qenë fokus i shumë studiuesve siç janë Richard Dugdale dhe Henry Goddard të cilët kanë marrë në studim pemën gjenetike të dy familjeve të ndryshme dhe kanë dalë në përfundimin se paqëndrueshmëria mendore mund të jetë një shkak i trashëgueshëm i sjelljes kriminale.

13 S.Kurti, “Cikël leksionesh”, Tema 3, Master Ekzekutiv në Kriminologji, 2021.

14 SH.Fakhrzadegan, et al, “The Relationship between Personality Disorders and the Type of Crime Committed and Substance Used among Prisoners”, Iran 2017.

15 S.Kurti, “Cikël leksionesh”, Tema 3, Master Ekzekutiv në Kriminologji, 2021.

Nga ana tjetër, Lee Robins zhvilloi studime për të shpjeguar lidhjen mes kriminalitetit të prindërve dhe fëmijëve. Në vitin 1975 së bashku me Patricia West dhe Barbara Herjanic zbuluan se fëmijët që kishin të dy prindërit kriminel paraqesnin rrezikshmëri më të lartë për t'u bërë të tillë.¹⁶

Faktorët gjenetik duket se luajnë rol në shkaqet e ç'rregullimit të personalitetit antishoqëror dhe rrjedhimisht, fëmijët e prindërve me këtë çrregullim paraqesin një shkallë më të madhe sjellje antishoqërore.¹⁷ Përfshirja e të miturve në sjellje kriminale është një problem i cili ka shqetësuar dhe vazhdon të shqetësojë çdo shoqëri. Episodet e dhunës në moshë të rritur shpesh paraprihen nga probleme të sjelljes në moshë të re dhe të rinjtë që kanë probleme të tilla të hershme zakonisht diagnostikohen me ç'rregullim të sjelljes, e cila në mënyrë të pavarur ose në kombinim me sëmundje mendore paraqet rritje të rrezikut për dhunë në moshën e rritur.¹⁸ Zakonisht, personat e dhunuar në fëmijërinë e tyre, përjetojnë një traumë psikologjike e cila akumulohet dhe në momentin e parë që personi ndihet sado pak "*i fuqishëm*", do të kryej ndaj personave të tjerë të njëjtat veprime që janë ndër-marrë ndaj tij. Personat që keqtrajtojnë një fëmijë, nuk e kuptojnë se me veprimet e tyre po rrisin një person i cili në të ardhmen mund t'i reflektojë këto veprime edhe në sjellje të tjera të rënda (sjellje kriminale dhe antishoqërore) në ambjentin ku jeton dhe kjo lidhet me "*ciklin e dhunës*"¹⁹. Probabiliteti më i madh është se një person që është dhunuar, do të dhunojë. Normalisht, jo çdo person i dhunuar në fëmijërinë e tij do të shfaq të njëjtat sjellje kur të jetë madhor pasi kjo lidhet me personalitetin e gjithësecilit prej nesh, me pasjen apo jo të çrregullimeve të shëndetit mendor si dhe me anën e errët të personalitetit. Nga përdorimi i të dhënave nga një klinikë mbi trajtimin e skizofrenisë për të krahasuar shkallën e dhunës në pacientët që kishin dhe nuk kishin çrregullime të sjelljes si fëmijë, rezultoi se shkalla e dhunës ishte dukshëm më e lartë tek pacientët që kishin pasur probleme të çrregullimit të sjelljes dhe shkalla e ngritjes ndryshonte në mënyrë të njëtrajtshme me numrin e problemeve të sjelljes, madje edhe në prani të kontrolleve të gjera, përfshirë përdorimin e substancave.²⁰ Shmangia e këtyre sjelljeve duhet të bëhet në të tashmen, për të parandaluar pasojat në të ardhmen. Fillimisht, ndaj fëmijëve duhet të shmanget përdorimi i dhunës në të gjitha format e saj dhe në rastet kur fëmijët shfaqin probleme të shëndetit mendor këto probleme duhet të trajtohen që në fillimet e tyre për të mos agravuar më pas në sjellje kriminale.

16 Po aty, Tema 2.

17 K.Gusha(Çela), "Trendi në incidencën e rasteve të diagnostifikuara me probleme të shëndetit mendor në Shkodër gjatë viteve 2005-2015", Disertacion Doktorature, Tiranë 2018, faqe 50.

18 T.Moberg, etc, "Psychiatric and neurological disorders in late adolescence and risk of convictions for violent crime in men.", 2015.

19 Po aty.

20 R.Frank, Th.McGuire, "Mental Health Treatment and Criminal Justice Outcomes", University of Chicago 2010, faqe 179 .

Një çështje me rëndësi është dhe trajtimi i të miturve që kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor dhe që janë përfshirë në sjellje kriminale të shtyrë nga këto probleme. Bërësit e politikave i kushtojnë më shumë vëmendje rehabilitimit dhe trajtimit si një mënyrë për të zvogëluar krimin, sesa për dënimin më të rreptë.²¹ Ndëshkimi i tyre me një dënim të ashpër dhe mbyllja e tyre në një institucion të vuajtjes së dënimit nuk do të sjellë asgjë tjetër përveç rëndimit të situatës së tyre. Zgjerimi i programeve të devijimit, pasqyron një pikëpamje gjithnjë e më të përhapur, se ekziston një lidhje shkakësore midis ç'rregullimeve mendore të të rinjve dhe krimit.²² Edhe legjislatori ynë, ashtu si edhe në shumë vende të tjera, në hartimin e akteve që trajtojnë problemet e të miturve i ka kushtuar rëndësi gjendjes mendore të të miturit në momentin e arrestimit të tij dhe në vijimësi të procesit duke sanksionuar kryerjen e kontrolleve të nevojshme nga mjekët specialist.²³

Në përfundim të këtij punimi po adresoj disa rekomandime në kuadër të trajtimit të personave me sëmundje të shëndetit mendor që janë përfshirë në vepra penale:

Legjislatori nuk duhet ti kushtojë rëndësi dënimit apo përjashtimit nga dënimi të këtyre autorëve, por duhet të fokusohet te mënyra e trajtimit të tyre. Një mënyrë e rritjes së vëmendjes ndaj këtyre autorëve është shtimi i institucioneve të posaçme me staf të kualifikuar.

Duhet bërë shtimi në Kodin Penal i masave psiko-sociale.

Kurimi në moshë sa më të hershme i sëmundjeve të shëndetit mendor tek fëmijët. Gjithashtu, trajtimi i fëmijëve, viktimat të dhunës, duhet parë edhe në këndvështrimin e shfaqjes së problemeve të shëndetit mendor dhe trajtimi i tij duhet bërë që në momentin e dhunimit dhe jo pasi të ketë kryer vepër penale.

21 A cure for crime: Can mental health treatment diversion reduce crime among youth?", 2005.

22 Po aty.

23 Ligj nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", nenet 114-115.

BIBLIOGRAFI

Ligj nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligj nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Stephen J. Morse, “Mental Disorder and Criminal Justice”, Pennsylvania 2018.

David Kopel, “Facts about mental illness and crime”, 2015.

David B. Kopel, Clayton E. Cramer, “Reforming Mental Health Law to Protect Public Safety and Help the Severely Mentally Ill”, Howard Law Journal, 2015, Vol. 58 No. 3.

Tomas Moberg, Marlene Stenbacka, Anders Tengström, Erik Jonsson, Peter Nordstrom, Jussi Joinen, “Psychiatric and neurological disorders in late adolescence and risk of convictions for violent crime in men.”, 2015.

Alison Evans Cuellar, Larkin S. McReynolds, Gail A. Wasserman “A cure for crime: Can mental health treatment diversion reduce crime among youth?”, 2005.

Fakhrzadegan Shahin, Gholami-Doon Hossein, Shamloo Bagher and Shokouhi-Moghaddam Solmaz, “The Relationship between Personality Disorders and the Type of Crime Committed and Substance Used among Prisoners”, 2017.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, “Shëndeti mendor dhe burgjet”.

Heather Stuart, “Violence and mental illness: an overview”, 2003.

Kolos Ukaj, “Faktorët kriminogjenë dhe shkaqet determinuese të tyre”, Revistë Studimore - Shkencore “Dardania”, Kosovë 2015.

Richard G. Frank, Thomas G. McGuire, “Mental Health Treatment and Criminal Justice Outcomes, University of Chicago, 2010.

Skerdian Kurti, “Cikël leksionesh”, Master Ekzekutiv në Kriminologji, 2021.

Kilda Gushta(Çela), “Trendi në incidencën e rasteve të diagnostifikuara me probleme të shëndetit mendor në Shkodër gjatë viteve 2005-2015”, Disertacion Doktorature, 2018.

Kreshnik Myftari, “Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore. Kriteri juridik në të drejtën penale”, Disertacion Doktorature, 2014.

THE IMPORTANCE OF AGRICULTURE AS A KEY FACTOR IN ALBANIA ECONOMIC DEVELOPMENT

Brisejda ÇAKËRRI

*Lecturer, Department of Economy, Faculty of Economy and Social Sciences,
University College "Pavaresia Vlorë" Vlorë, Albania
briseida.cakerri@unipavaresia.edu.al*

Abstract

Agricultural development means that agriculture should integrate into macroeconomics, which requires a structure for the general guarantee of economic policies. Agriculture in Albania, although it has a considerable impact on the country's GDP, has not yet at the right attention from the institutions of the country.

The purpose of this paper is the identification of Agriculture policy as a key factor in the country's economy and giving recommendations on the implementation of agricultural policies, with the main focus on making this most important sector for the Albanian economy.

Key words: *Agriculture, GDP, Economy, Policy, Impact.*

INTODUCTION

The role of agriculture has been changed as a sector destined to provide resources to promote industrialization, into an important sector with the purpose of increasing export revenues, generating employment, and improving food security. Agricultural development means that agriculture should integrate into macroeconomics, which requires a structure for the general guarantee of economic policies. As we will see in this paper, subsidies and facilities for the agricultural sector are not many, or maybe even insignificant, compared to other countries in Europe and the Balkans.

The most developed in this sector are foreign direct investments which have given a great help in the development of the Agriculture sector in the country, there

is also FDI in Agriculture that have a greater impact on the country's GDP than Agricultural Subsidies, this it also appears from the Spearman correlation coefficient that is addressed in this paper

HOW AGRICULTURE AFFECT THE ECONOMY DEVELOPMENT OF THE COUNTRY?

The basic characteristic of the new approach to economic development is its emphasis on an expanded role of markets and a reduction or reorientation of the state role in the economy. The overall goal of this approach requires the withdrawal of the state from those tasks that the market can perform effectively, and focusing its activities on those tasks in which markets fail. The disappointing performance of most developing countries during the 1980s (for some a "lost decade" of economic development) has provided an incentive for a rethinking the dominant development model by emphasize market failures in support of serious intervention of government . The role of agriculture has been raised from a sector intended to provide resources to promote industrialization, to an important sector for increasing export earnings, generating employment, and improving food security. Agricultural development presupposes the integration of agriculture into macroeconomics, which requires a foundation for the overall guarantee of economic policies, which are:

the stability of the rules for a decentralized calculation of profit and loss also property rights are quite important regard to this;

(b) a government capable of identifying and providing productive social physical and intangible capital.

In this context, attention is paid to the role of the public sector in shaping the economic environment of agriculture.

THE ROLE OF AGRICULTURE IN ECONOMIC DEVELOPMENT.

The purpose of medium-term policies is to create the conditions for the efficient allocation of productive resources between sectors and within agriculture. Short-term policy reforms aimed at correcting economic inequalities and mitigating crises, although necessary, may not be sufficient to resume growth. Long-term growth strategies to include and go beyond short-term policies and they also are based on identifying those sectors where public investment financing will give priority. Agricultural-based development strategies go beyond the adoption of short-term measures who eliminate discriminatory policies towards agriculture. Is suggested an active support of the agricultural sector in terms of massive public investment allocations, noting the broad benefits of such a strategy in terms of improving food

and nutrition security, an income distribution, and the generation of employment and, most importantly, encouragement overall growth through output (supply) and income (demand) links between agriculture and the rest of the economy.

Mellor and Johnston two economists proposed an “interconnected” strategy, which highlights the benefits resulting from increasing productivity of small (mainly food) producers through infrastructure development and the spread of appropriate labor-intensive technologies. A strategy like this would improve the nutritional “status” of the population on both sides of increasing food production and (most importantly) increasing agricultural employment, that would be followed with the increase income of farmers.

While considering the role of agriculture in the development, one strategy cannot and should not ignore the fact that economic development ultimately leads to a reduced role of agriculture in the overall economy in the long run. The debate based on agricultural development strategies does not recognize the need for such a transformation, but rejects the idea of agriculture as a resource reserve. In other words, this transfer takes place as a result of increased agricultural productivity which, in combination with the fact that the demand for agricultural products grows faster than for other products, makes it economically more favorable for resources to be directed more and more to other sectors such as development advances. The state role is important on these strategies in promoting technological improvements of agriculture (including human capital) to increase productivity, and to promote institutions that facilitate the normal functioning of entry and exit markets.

PROBLEMS IN ALBANIA.

Even that agriculture should be one of the most important factor of Albania economy our country is so behind in this sector. Is more than enough the published statistic of agriculture for our country. For example let's see the vegetable production in 2020 compared with the year 2019.

The highest level of vegetables production was achieved in the prefectures of Fier with 503,531 tonnes, Berat with 131,735 tonnes and Tirana with 130,001 tonnes.

I. Tab.1 Agriculture production (thousand tones)

Agriculture production	2016	2017	2018	2019	2020
Field crops					
Cereals	698.4	701.7	678.2	666.1	684
Vegetables	1,129.10	1,151.90	1,166.30	1,258.00	1,295.70

Potatoes	238.3	249.8	254.5	260.7	254,8
White beans	25	21.2	24.5	24.8	25.8
Industrial crops	-	32,7	30,8	33,7	30,1
Medicinal crops	10.6	12.8	12.5	12.9	14.4
Forage	6,144.00	6,688.60	7,050.10	7,115.20	7,170.50
Permanent crops					
Fruit trees	261	262.6	274.3	272.6	273.7
Olives	99	107.8	117.6	98.3	131.9
Citrus	40	41	45.5	46.9	49.2
Grapes	205.1	202.9	184.8	189.9	199.1

The cereals production in 2020 is 684,023 tonnes, increased by 2.61 % compared with the previous year. The highest level of cereals production was achieved in the prefectures of Fier with 170,229 tonnes, following by Elbasan with 99,858 tonnes and Korça with 78,801 tonnes.

In 2020, the potatoes production is 254,886 tonnes, decreased by 2.22 % compared with the year 2019. The highest level of potatoes production was achieved in the prefectures of Korça with 59,316 tonnes, following by Fier with 50,146 tonnes and Elbasan with 28,684 tonnes.

Even if we have increase of the percent one thing we know for sure that we have more problems, is sufficient for us to remember the action of the farmers which threw away in garbage a big part of their production because nobody could bought it. Another problem that lid with the production selling is promotion this products. Is important to build a marketing model for this products which are made in Albania.

In the period before the '90s, significant quantities of alcoholic beverages and wine were exported. The types of wines exported were: "Merlot", "Shesh", "Riesling", sweet wine "Malaga" and "Rozafa", as well as cognac "Skënderbeg". At about 30,000 hl per year. After the '90s the export was completely stopped. Export alternatives for Albanian wine in the first place should be seen in the domestic tourism market.

In the first view looks like our country is making regres in this sector. But in the last years seems like our government is hearing the problem of the farmers.

Two politics that should been mentions are:

1. zero VAT for agriculture.
2. free oil for farmers.

This is a small step in this sector, but our government needs to pay and to give more attention to agriculture economy. Another big problem is the movement of population from rural zone. These people are in search to better opportunities be-

cause they have been forgotten for a long time. They are leaving their home, their city and their profession because in the end of the month they can't pay their bills.

CONCLUSION

The agricultural sector is still not being given the right importance, which together with tourism could be the strongest factors of our country's economy. Agriculture is an extraordinary opportunity to generate higher incomes given the fact that the EU imports more than 120 billion euros a year in agricultural products, noticing now how "thirsty" this market is for this sector, without calculated here our domestic demand who is covered by imports of Northern Macedonia, Italy, Greece, etc.

One of the first steps that would have to be taken is the reconstruction and the way of organizing the agricultural mechanisms. More specifically, this would require the establishment of intermediate structures for collection, storage with projects and detailed plans for the question of what should be produced, what the market specifically demands, in this way farmers are oriented towards demand.

Another step would be for the state to establish connection between Albanian farmers and foreign markets. This would be one of the most efficient steps which will directly affect not only the pockets of farmers, who today make "demonstrations" by dumping their products on the streets, but also in the economy of our country, a country which has all the necessary potential to do it.

Of great importance is the "education" of farmers where through instructions on how to use fertilizers, cultivation of products, how to maintain products, and by teaching them the new technological developments would help them produce more efficiency and safety productions for the market

WORK CITED

Agriculture Statistics, 2020 Instat, <http://www.instat.gov.al/en/themes/agriculture-and-fishery/agriculture/publication/2021/agriculture-statistics-2020/>

Buletini Ekonomik Vellimi 4 Institucionet Financiare Rurale dhe Financimi I Ekonomive Fermere

Benin, S., T. Mogues, G. Cudjoe, and J. Randriamamonjy. 2012. "Public Expenditures and Agricultural Productivity Growth in Ghana." In *Public Expenditures for Agricultural and Rural Development in Africa*, edited by T. Mogues and S. Benin. London and New York: Routledge, Taylor and Francis Group.